*Shënim: ML9.f përfshin bashkuesit për anijet, të llojit me një ose me shumë drejtues, koaksialë ose me orientim vale, dhe mjetet që futen në trupin e anijes, që të dyja të papërshkueshme nga uji dhe kanë karakteristikat e kërkuara për kërkime në thellësi mbi 100 m; dhe fibrat optike dhe mjetet optike që futen në trupin e anijes, të projektuara për transmetimin e rrezeve "laser" pavarësisht thellësisë. ML9f. nuk zbatohet për boshtet e zakonshme lëvizëse dhe as për drejtimin hidrodinamik të shufrave depërtuese të trupit të anijes;*

g. Kushinetat pa zhurmë, komponentët dhe pajisjet që përmbajnë këto lloj kushinetash, të projektuara për përdorim ushtarak, të cilat kanë karakteristikat e mëposhtme:

1. Zbutje magnetike ose me gaz;

2. Kontroll aktiv të zhurmave akustike

3. Reduktim të dridhjeve

**ML10 "Avionët", "mjetet fluturuese më të lehta se ajri", mjetet fluturuese pa personel ("UAV"), motorët ajrorë dhe pajisjet e avionëve, si komponentët e lidhur me to të projektuar ose modifikuar për përdorim ushtarak:**

*VINI RE: Për udhëzim dhe pajisje orientuese, shih ML11.*

a "Avionët" me ekuipazh dhe " mjetet më të lehta se ajri", si dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

b. Nuk janë përdorur që nga viti 2011;

c. Avionët pa ekuipazh, pajisjet për ta dhe komponentët e projektuar posaçërisht për ta, si më poshtë:

1. Mjetet fluturuese pa ekuipazh, mjetet fluturuese me komandim nga distanca (RPV), mjetet fluturuese me programim autonom dhe "mjetet më të lehta se ajri";

2. Hedhësit, pajisjet e riparimit dhe pajisjet për mbështetje tokësore;

3. Pajisjet e komandimit dhe kontrollit;

d. Motorët e avionëve dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

e. Pajisjet ajrore për furnizimin me karburant, të projektuara ose të modifikuara posaçërisht për ndonjë nga sa vijon dhe komponentët e tyre:

1. "Avionët" e specifikuar në ML10.a; ose

2. Avionët pa ekuipazh të specifikuar në ML10.c.

f. "Pajisjet e terrenit" të projektuara për avionët e specifikuar në ML10.a ose në listën e motorëve për mjetet fluturuese të specifikuar në ML10.d.

*Shënim teknik:*

*"Pajisjet e terrenit" përfshijnë pajisjet për rimbushjen e karburantit nën presion dhe pajisjet e projektuara për punë në hapësira të kufizuara.*

g. Pajisjet për mbijetesën e ekuipazhit, pajisjet e sigurisë së ekuipazhit dhe pajisje të tjera për dalje në rast emergjence, përveç atyre të specifikuara në ML10.a, të projektuara për "avionët" e specifikuar në ML10.a.

*Shënim: ML10.g. nuk kontrollon helmetat e ekuipazhit, të cilat nuk përfshijnë ose nuk kanë instalime ose pjesë për vendosjen e pajisjeve ose të armëve të listuara në Listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së;*

*VINI RE: Për helmetat, shih gjithashtu ML13.c.*

h. Parashutat, deltaplanët me motor (paragliders) dhe pajisjet e lidhura me to, si dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to, si më poshtë:

1. Parashutat që nuk renditen diku tjetër në listën ushtarake

2. Deltaplanët me motor (paragliders)

3. Pajisjet e projektuara për parashutistët e lartësive të mëdha (p.sh., kostumet, helmetat e posaçme, sistemet e frymëmarrjes, pajisjet e navigimit);

i. Pajisjet për kontrollin e hapjes ose sistemet e pilotit të destinuara për hedhjen e ngarkesave me parashutë.

*Shënim 1: ML10.a. nuk zbatohet për "avionët" dhe "mjetet më të lehta se ajri" ose variantet e "avionëve" të projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak:*

*a. Avionët joluftarakë*

*b. Nuk janë të konfiguruar për përdorim ushtarak, nuk janë të pajisura me pajisje ose montime të projektuara ose të modifikuara për përdorim ushtarak; dhe*

*c. Nuk janë certifikuar për përdorim civil nga autoriteti i aviacionit civil në një shtet anëtar ose në një shtet anëtar të Marrëveshjes së Wassenaar-it.*

*Shënim 2: ML10.d. nuk zbatohet për:*

*a. Motorët e mjeteve fluturuese të projektuara ose modifikuara për përdorim ushtarak, të cilat janë certifikuar nga autoritetet e aviacionit civil në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian ose shtetit anëtar pjesëmarrës në Marrëveshjen e Wassenaar-it për përdorim në "avionët civilë", ose komponentët e projektuar posaçërisht për to;*

*b. Motorët për mjete fluturuese ose komponentë të veçantë të tyre, përveç atyre të projektuar posaçërisht për avionët pa ekuipazh.*

*Shënim 3: Për qëllimet e ML10.a. dhe ML10.d., komponentët e projektuar posaçërisht dhe pajisjet e lidhura për "avionë joushtarakë" ose motorët për këto mjete të modifikuara për përdorim ushtarak,*



zbatohet vetëm për ata komponentë ushtarakë dhe për pajisjet ushtarake të lidhura të nevojshme për modifikim për përdorim ushtarak.

Shënim 4: Për qëllimet e ML10.a., përdorimi ushtarak përfshin: luftën, zbulimin ushtarak, sulmet, stërvitjet ushtarake, mbështetjen logjistike, trupat të transportit dhe parashutat ose pajisjet ushtarake.

Shënim 5: ML10.a. nuk zbatohet për "avionët" që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a. Janë prodhuar përpara vitit 1946;

b. Nuk përfshijnë mallrat e listuara në listën e përbashkët ushtarake, nëse mallrat nuk janë të nevojshme për përmbushjen e standardeve të sigurisë dhe navigimit, të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose të anëtarëve të Marrëveshjes së Wassenaar-it; dhe

c. Nuk përfshijnë armët e përcaktuara në listën e përbashkët ushtarake, përveçse nëse ato janë të padëmshme dhe në funksion të tyre.

**ML11 Pajisjet elektronike, "anijet kozmike" dhe komponentët e tyre që nuk janë përmendur në asnjë mënyrë në listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian, si më poshtë vijon:**

a. Pajisjet elektronike të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe komponentët e projektuar për to;

Shënim: ML11.a. përfshin:

a. Pajisjet kundërvepruese dhe pajisjet elektronike kundër-kundërvepruese (p.sh pajisjet e projektuara për të lëshuar sinjale të huaja ose të gabuara në radar ose në pajisjet e lidhjes me radio ose që të pengojnë marrjen, punën ose efektivitetin e pajisjeve marrëse të kundërshtarit), ku përfshihen dhe pajisjet e tyre kundër-kundërvepruese

b. Llambat e frekuencave të shpejta;

c. Sistemet elektronike ose pajisjet e projektuara dhe për zbulim dhe monitorim të spektrit elektromagnetik për zbulimin ushtarak ose për qëllime sigurie ose për kundërveprimin dhe mbikëqyrjen e tyre;

d. Kundërveprimet nën ujë, ku përfshihen zhurmimi dhe prishja e sinjalit akustik, pajisjet e projektuara për të lëshuar sinjale të huaja ose të gabuara në pajisjen marrëse të hidrolokatorit;

e. Pajisjet e përpunimit të të dhënave të sigurisë, pajisjet e të dhënave të sigurisë dhe të transmetimit dhe sinjalizimit që përdorin proceset e kodimit;

f. Pajisjet identifikuese, të autenticitetit, shkarkuese dhe menaxhuese, prodhuese dhe shpërndarëse;

g. Pajisjet udhëzuese dhe orientuese;

h. Pajisjet e transmetimit të radio-komunikimeve dixhitale;

i. Demulatorët dixhitalë të projektuar posaçërisht për zbulimin e sinjaleve.

j. "Sistemet e automatizuara të komandimit dhe kontrollit."

VINI RE: Për "softuerët" lidhur me radiot e përcaktuara nga "softueri"(SDR), shih ML21.

b. Pajisjet bllokuese të sistemeve satelitore të navigimit dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

c. "Anijet kozmike" të projektuara ose të modifikuara për përdorim ushtarak dhe komponentët e "anijeve kozmike" të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak.

**ML12 Sistemet e armëve me energji të lartë kinetike dhe pajisjet e projektuara posaçërisht për to, si më poshtë:**

a. Sistemet e armëve me energji të lartë kinetike të projektuara posaçërisht për të shkatërruar objektivin ose për të anuluar shkatërrimin e tij;

b. Pajisjet e projektuara posaçërisht për testim dhe vlerësim dhe modelet e testimit, përfshirë instrumentet diagnostifikuese dhe objektivat, për testim dinamik të raketave dhe sistemeve me energji kinetike.

*VINI RE: Për sistemet e armëve që përdorin municion nën-kalibër ose që përdorin barute kimike me municionet për këto armë, shih ML1 deri në MLA.*

*Shënim 1: ML12 përfshin sistemet e armëve me energji kinetike në vijim:*

*a. Sisteme shtytëse lëshuese që mund t'i japin shpejtësi masave më të mëdha se 0.1 g në shpejtësi më të mëdha se 1.6 km/s, si në modelin e qitjes një nga një dhe në atë të qitjes me shpejtësi;*

*b. Sistemet që sigurojnë energji kryesore, mbrojtje elektrike, ruajtje të energjisë, menaxhim termik, manovrim të karburantit; dhe ndërfaqet elektrike midis burimit të energjisë, armës dhe funksioneve të tjera elektrike që ndikojnë;*

*c. Sistemet për përcaktimin e pozicionit dhe ndjekjen e objektivit, për kontrollin e zjarrit dhe për vlerësimin e dëmit;*

*d. Sistemet e kërkimit të objektivit, sistemet orientuese ose shmangëse të shtyrjes (shpejtësia laterale) për raketat.*

*Shënim 2: ML12 zbatohet për sistemet e armëve që përdorin si forcë shtytëse një nga metodat e mëposhtme:*

*a. Elektromagnetike;*

*b. Elektrotermale;*

*c. Plazma;*

*d. Gaz i lehtë; ose*

*e. Kimike (kur përdoret në kombinim me ndonjë nga elementët e mësipërm).*

**ML13 Pajisjet e blinduara ose mbrojtëse, strukturat dhe përbërësit si më poshtë:**

a. Pllakat e blinduara si më poshtë:

1. Të prodhuara në përputhje me standardet ushtarake; ose

2. Të përshtatshme për përdorim ushtarak;

VINI RE: *Pllakat mbrojtëse të destinuara për anti-plumbat shih ML13.d.2.*

b. Konstruksionet e materialeve metalike ose jo metalike ose kombinimet e tyre të projektuara për të siguruar mbrojtje balistike për sistemet ushtarake dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

c. Helmetat e prodhuara në përputhje me standardet ose specifikimeve ushtarake, ose sipas standardeve kombëtare të krahasueshme, dhe komponentët e posaçëm të tyre, (p.sh., kasketat, jelekët për zbutjen e goditjes;

d. Jelekët antiplumb, veshjet mbrojtëse dhe komponentët e tyre, si më poshtë:

1. Jelekët antiplumb, veshjet mbrojtëse dhe pajisjet e projektuara për to, të prodhuara në përputhje me standardet ushtarake ose ekuivalentet e tyre;

*Shënim: Për qëllimet e ML13.d.1, standardet ose specifikimet ushtarake përfshijnë të paktën specifikimet për mbrojtjen nga copëzat e mbeturinave.*

2. Pllakat e forta të jelekëve mbrojtës që ofrojnë mbrojtje balistike të barabartë ose më të madhe se niveli III (NIJ 0101.06, korrik 2008) ose ekuivalentet kombëtare.

*Shënim 1: ML13.b. përfshin materialet e projektuara posaçërisht për të siguruar mbrojtje nga armët e shpërthimit reaktiv ose për ndërtimin e strehimeve ushtarake.*

*Shënim 2: ML13.c nuk zbatohet për helmetat konvencionale prej çeliku, as ato të modifikuara ose të projektuara për tu pranuar, as ato të pajisura me pjesë shtesë;*

*Shënim 3: ML13.c. dhe d. nuk zbatohet për helmetat, jelekët antiplumb ose veshjet mbrojtëse të përdorura për mbrojtjen personale të përdoruesit.*

*Shënim 4: Helmetat e vetme të projektuara posaçërisht për personelin e çmontimit të bombave që përcaktohen me hollësi tek ML13, janë ato të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak*

VINI RE 1: *Shih gjithashtu IA005 në listën e mallrave me përdorim të dyfishtë.*

VINI RE 2: *Për "materialet fibroze ose filamenti" të përdorura për prodhimin e jelekëve antiplumb dhe helmetave, shih IC010 në listën e mallrave me përdorim të dyfishtë të BE-së.*

**ML14 Pajisjet e specializuara për stërvitje ushtarake ose për simulim të skenarëve ushtarakë, simulatorët e projektuar posaçërisht për stërvitje në përdorimin e ndonjë arme zjarri ose arme të përcaktuar në ML1 ose ML2, dhe komponentët e pajisjet e projektuara posaçërisht për to.**

*Shënim teknik*

*Termi "pajisje të specializuara për stërvitje ushtarake" përfshin llojet e simulatorëve të sulmit, simulatorëve operacionalë të fluturimit, simulatorët e radarëve të objektivave, gjeneratorët e gjetjes së objekteve, pajisjet e stërvitjes me top, simulatorët e stërvitjes për luftën kundër nëndetëseve, simulatorët e fluturimit (ku përfshihen dhe centrifugat për njerëzit për stërvitjen e pilotëve dhe astronautëve), pajisjet e stërvitjes për radarët, simulatorët e fluturimit me instrumente, simulatorët e orientimit, simulatorët e lëshimit të raketave, pajisjet e gjetjes së objektivit, avionëve pa personel, simulatorët e armatimit, simulatorët e "avionëve" pa ekuipazh, njësitë e stërvitjes së lëvizshme dhe pajisjet për operacionet tokësore.*

*Shënim 1: ML14 përfshin sistemet për gjenerimin e imazhit dhe ambienteve ndërvepruese për simulatorët, kur janë të projektuara ose të modifikuara për përdorim ushtarak.*

*Shënim 2: ML14 nuk zbatohet për pajisjet e projektuara posaçërisht për stërvitje dhe përdorimin e armëve të gjuetisë ose armëve sportive.*

**ML15 Pajisjet e imazhit ose të kundërveprimit dhe komponentët dhe aksesorët e tyre në vijim, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak:**

- a. Regjistruerit dhe pajisjet e përpunimit të imazhit;
- b. Kamerat, pajisjet fotografuese dhe të përpunimit të filmit;
- c. Pajisjet intensifikuese (përforcuese) të imazhit;
- d. Pajisjet me rreze infra të kuqe ose pajisjet termike të imazhit;
- e. Pajisjet për fotografimin e sensorëve të radarëve
- f. Pajisjet e kundërveprimit ose të kundër-kundërveprimit për pajisjet e specifikuar në ML15.a deri në ML15.e.

*Shënim: ML15.f. f. përfshin pajisjet e projektuara për të reduktuar veprimin ose efektivitetin e sistemeve ushtarake të imazhit ose për të minimizuar këto efekte reduktuese.*

*Shënim 1: Në ML15, termi "komponentë të projektuar posaçërisht" përfshin, komponentët e mëposhtëm kur janë të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak:*

- a. Llambat e konvertimit të imazhit infra të kuq;
- b. Kinoscope/llambat e intensifikimit të imazhit (përveç atyre të gjeneratës së parë);
- c. Pllakat me mikrokanale;
- d. Llambat e kamerave televizive me nivel të ulët ndriçimi
- e. Shigjetat detektuese (ku përfshihen ndërlidhja elektronike ose sistemet lexuese);
- f. Llambat piroelektrike të kamerave televizive;
- g. Sistemet e ftohjes për sistemet e imazhit;
- h. Diafragmat me mbyllje elektrike të tipit fotokromik ose të tipit elektro-optik që kanë një shpejtësi të diafragmës më të vogël se 100  $\mu$ s, përveçse në rastet të cilat janë pjesë bazë e një aparati fotografik për shpejtësi të larta;
- i. Inverterat e imazhit me fibër optike;
- j. Fotokatodat e përbëra gjysmëpërcjellëse.

*Shënim 2: ML15 nuk zbatohet për "llambat intensifikuese (përforcuese) të gjeneratës së parë" ose pajisjet e projektuara posaçërisht për tu bashkuar në llambat intensifikuese (përforcuese) të gjeneratës së parë".*

*VINI RE: Për klasifikimin e shënjestrave të armëve që kanë "llamba intensifikuese të gjeneratës së parë", shih ML1, ML2. dhe ML5.a.*

*VINI RE: Shih gjithashtu 6A002.a.2. dhe 6A002.b. në listën e mallrave me përdorim të dyfishtë.*

**ML16 Produktet e farkëtuara, të derdhura dhe produkte të tjera të papërfunduara, të projektuara posaçërisht për artikujt e specifikuar në ML1 deri në ML4, ML6, ML9, ML10, ML12 ose ML19.**

*Shënim: ML16. zbatohet për produktet e papërfunduara, kur ato janë të identifikueshme nga përbërja e materialit, gjeometria ose funksioni.*

**ML17 Pajisje, materiale dhe dokumentacione të ndryshme, dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to:**

a. Të gjitha pajisjet për zhytje si më poshtë:

1. Aparatet me qarkullim të mbyllur ose gjysmë të mbyllur (rifrymëmarrje) të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak (p.sh. të projektuara posaçërisht për të qenë jo magnetik);
2. Përbërësit e projektuar posaçërisht për të kthyer aparatin e qarkullimit të hapur për përdorim ushtarak;
3. Artikujt personalë të zhytjes dhe aparati i notimit nën ujë të projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak.

b. Pajisjet e ndërtimit të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

c. Përshtatjet, veshjet dhe trajtimet për fshehje gjurmësh të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

d. Pajisjet xheniere fushore të projektuara për përdorim në zonën e luftimit;

e. "Robotët", kontrolluesit e "robotëve" dhe "ndikuesit fundorë", që kanë ndonjë nga karakteristikat që vijojnë:

1. Janë projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak;
2. Mjetet e inkuorporuar të mbrojtjes së linjave hidraulike ndaj shpimit nga fragmentet balistike (p.sh. inkuorporojnë linja vetizoluese) dhe janë projektuar për të përdorur lëngje hidraulike në pikë ndezje më të lartë se 839 K (566 °C); ose
3. Janë projektuar posaçërisht ose kategorizohen për të vepruar në një mjedis me rrymë elektromagnetike;

*Shënim teknik*

*Pulset elektromagnetike nuk I referohen efektit të ndërsjellë të shkaktuar në mënyrë të paqëllimshme nga rrezatimi elektromagnetik nga pajisjet në afërsi (p.sh., makineritë dhe pajisjet elektronike) ose për shkak të rrufeve.*

f. Bibliotekat (bazat e të dhënave me parametra teknikë) të projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak me pajisjet e kontrolluara nga Lista e Përbashkët Ushtarake e BE-së;

g. Pajisjet e gjenerimit të rrymës bërthamore ose pajisjet shtytëse, ku përfshihen "reaktorët bërthamorë", komponentët e tyre të projektuara për përdorim ushtarak;

- h. Pajisjet dhe materialet, e veshura ose të përpunuara për maskim të gjurmës, të projektuara për përdorim ushtarak, përveç atyre të kontrolluara në vend tjetër në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së;
- i. Simulatorët e projektuar veçanërisht për reaktorët bërthamorë ushtarakë;
- j. Ofiçinat e lëvizshme të riparimit të projektuara ose modifikuara për riparimin e mjeteve ushtarake;
- k. Gjeneratorët për në terren, të ndërtuar ose modifikuar për përdorim ushtarak;
- l. Kontejnerët e projektuar ose modifikuar për përdorim ushtarak;
- m. Tragetet, përveç atyre të specifikuara në pika të tjera në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së, urat dhe mjetet lundruese të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;
- n. Modelet e testit të projektuara posaçërisht për "zhvillimin" e artikujve të përcaktuar në ML4, ML6, ML9 ose ML10.
- o. Pajisjet mbrojtjes laser (p.sh. mbrojtje e sensorit dhe e syrit) të prodhuara posaçërisht për përdorim ushtarak.
- p. "Qeliza e karburantit" përveç atyre të specifikuara diku tjetër në Listën Ushtarake, të projektuara ose modifikuara për përdorim ushtarak.

#### *Shënime teknike*

1. Për qëllimin e ML17, termi "bibliotekë" ((bazë të dhënash – me parametra teknike) do të thotë mënyrat e grumbullimit të informacionit teknik me natyrë ushtarake, referencë për të cilën mund të rrisë performancën e sistemeve ose pajisjeve ushtarake.

2. Për qëllimin e ML17, "modifikim" do të thotë çdo ndryshim strukturor, elektrik, mekanik, që i jep një artikulli jo ushtarak mundësinë ekuivalente me një artikull që është projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak.

#### **ML18 Pajisjet për prodhimin e produkteve të përmendura në Listën e Përbashkët Ushtarake, si më poshtë:**

- a. Produktet e projektuara ose të modifikuara posaçërisht për "prodhimin" e produkteve të renditura në Listën e Përbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian, dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;
- b. Pajisjet e testimit mjedisor dhe pajisjet e tyre, të projektuara posaçërisht për to, për certifikimin, klasifikimin ose testimin e produkteve të specifikuara në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së.

#### *Shënim teknik*

*Për qëllimet e ML18, termi "prodhim" përfshin projektimin, ekzaminimin, prodhimin, testimin dhe kontrollin.*

*Shënim: ML18.a. dhe ML18.b. përfshijnë pajisjet e mëposhtme:*

- a. Pajisjet për nitrin të vazhdueshëm;*
- b. Aparatet e testimit centrifugal ose pajisjet që kanë karakteristikat e mëposhtme:*

1. *Vihen në punë nga një motor ose motorë me fuqi më të madhe se 298 kw (400 kuaj fuqi);*
2. *Kanë kapacitet për të mbajtur ngarkesa prej 113 kg ose më shumë; ose*
3. *Kanë kapacitet për të ushtruar përshejtim centrifugal prej 8 g ose më shumë në një ngarkesë 91 kg ose më të madhe;*
- c. *Presat dehidratuese;*
- d. *Nxjerrësit e vidave të projektuar ose të modifikuar për nxjerrjen e eksplozivëve ushtarakë;*
- e. *Makineritë prerëse për lëndët shtytëse të dala;*
- f. *Mbështetëset (mbajtëset) me diametër 1,85 m ose më tepër dhe me kapacitet më të madh se 277 kg;*
- g. *Përzierësit e vazhdueshëm për lëndët shtytëse të ngurta (përzierësit e barutit);*
- h. *Mullinj të energjisë fluide për grirje ose copëtim të përbërësve të eksplozivëve ushtarakë;*
- i. *Pajisjet për arritjen e madhësisë së grimcës dhe të formës sferike të pluhurit të metalit të paraqitur në listën ML8.c.8;*
- j. *Konvertuesit me konveksion të rrymës për shndërrimin e materialeve të listuara në ML8.c.3*

**ML19 Sistemet e armëve me energji të drejtuar (DEW), pajisjet e lidhura ose pajisjet e kundërmasave dhe modelet e testimit, si dhe përbërësit e projektuar posaçërisht për to, si më poshtë:**

- a. Sistemet "Laser" të projektuar posaçërisht për shkatërrim ose për anulim të misionit të objektivit;
- b. Sistemet me rryma grimcash të afta për shkatërrim ose për anulim të misionit të objektivit;
- c. Sistemet me radiofrekuencë të lartë (RF), të cilat janë në gjendje të shkatërrojë ose të anulojnë detyrën e synuar;
- d. Pajisjet e projektuar posaçërisht për zbulimin dhe identifikimin sistemeve të përcaktuara në ML19.a deri në ML19.c ose për mbrojtjen ndaj tyre;
- e. Modelet e testit fizik për sistemet, pajisjet dhe komponentët e përcaktuar në ML19.
- f. Sistemet "laser" të projektuar posaçërisht për të shkaktuar humbje të përhershme të shikimit, nëse sytë nuk janë të mbrojtura, p.sh për syrin e lirë, ose për syrin me pajisje korrigjuese;

*Shënim 1: Sistemet e armëve me energji të drejtuar (pajisjet DEW) të përcaktuara në ML19 përfshijnë sistemet aftësia e të cilave rrjedh nga zbatimi i kontrolluar i:*

- a. *"Laserëve" me fuqi të mjaftueshme për të shkaktuar shkatërrim të ngjashëm me atë të municionit tradicional;*
- b. *Përshejtuesve të grimcave që projektojnë një tufë të ngarkuar ose neutrale me fuqi shkatërruese;*
- c. *radiotransmetuesve me frekuencë me pulsime të larta dhe me fuqi mesatare të lartë që prodhojnë fusha të tilla të forta që nxjerrin jashtë funksionit qarqet elektronike të një objekti të largët.*

*Shënim 2: ML19 përfshin si më poshtë vijon, kur janë projektuar posaçërisht për sistemet e armëve me energji të drejtuar (sistemet DEW);*

*a. Pajisjet për gjenerimin e energjisë kryesore, ruajtjen e energjisë, kyçjen-çkyçjen, kushtëzimin e fuqisë ose manovrimin e karburantit;*

*b. Sistemet për kapjen ose ndjekjen e objektivit*

*c. Sistemet e vlerësimit të dëmtimit të objektivit, shkatërrimit ose braktisjes së misionit;*

*d. Pajisjet e manovrimit të tufave të rrezes së përhapjes ose shënimit të një pike;*

*e. Pajisjet me lëvizje të shpejtë të tufës së rrezeve për veprimet e shpejta e të shumëfishta me objektivin;*

*f. Optika përshtatëse dhe bashkuesit e fazave;*

*g. Injektorët e rrymave për tufat e joneve negative të hidrogjenit;*

*h. Komponentët e përshpejtuar "të kualifikuar për përdorim në hapësirë";*

*i. Pajisjet për grumbullimin e rrezeve negative të jonit;*

*j. Pajisjet për kontrollin dhe devijimin e tufave të joneve me energji të lartë;*

*k. Mbrojtëset "e kualifikuara hapësinore" për neutralizimin e rrymave të izotopeve negative të hidrogjenit.*

**ML20 Pajisjet kriogjenike dhe "superpërcjellëse" siç tregohet në vijim dhe përbërësit dhe aksesoret e projektuar posaçërisht për to:**

a. Pajisjet e projektuara ose të konfiguruar për tu instaluar në një mjet për forcat tokësore, forcat detare, forcat ajrore, ose zbatimet hapësinore, të afta të punojnë ndërsa janë në lëvizje dhe të prodhojnë ose të mbajnë temperatura nën 103 K (-170 °C);

*Shënim: ML20.a përfshin sistemet e lëvizshme që inkorporojnë ose përdorin aksesore ose përbërësit e prodhuar nga materiale jo metalike ose jo elektrike, si plastika ose materialet epokside të pasuruara.*

b. Pajisjet elektrike "superpërcjellëse" (makineritë rrotulluese dhe transformatorët) e projektuar ose të konfiguruar posaçërisht për t'u instaluar në një mjet për forcat detare, tokësore, forcat ajrore ose zbatimet hapësinore, të afta për të punuar ndërsa janë në lëvizje.

*Shënim: ML20.b nuk zbatohet për gjeneratorët hibridë homopolar me rrymë të vazhduar që kanë armatura me një pol të vetëm metalik dhe rrotullohen në një fushë magnetike të prodhuara nga bobina superpërcjellëse, por me kusht që këto përshtjellime të jenë i vetmi komponent superpërcjellës në gjenerator.*

**ML21 "Softuerët", si më poshtë:**

a. "Softuerët" e projektuar ose të modifikuar për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e pajisjeve ose materialeve të specifikuar në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së;

b. "Softuerët" e posaçëm, përveç atyre të përcaktuara në ML21.a., si më poshtë:



1. "Softuerët" e projektuar posaçërisht për modelimin, simulimin ose vlerësimin e sistemeve të armëve ushtarake;
  2. "Softuerët" e projektuar posaçërisht për modelimin ose simulimin e skenarëve dhe operacioneve ushtarake;
  3. "Softuerët" për përcaktimin e efekteve të luftës konvencionale, bërthamore, kimike ose biologjike.
  4. "Softuerët" e projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak i dizajnuar për komandimin, komunikimin, kontrollin dhe shërbimet e inteligjencës (C3I) aplikimeve; ose komandimin, komunikimin, kontrollimin, llogaritjen dhe shërbimet e inteligjencës (C4I);
- c. "Softuerët" që nuk janë specifikuar në ML21.a. ose b., të projektuar ose të modifikuar për t'u mundësuar pajisjeve që nuk kontrollohen nga Lista e Përbashkët Ushtarake që të kryejnë funksionet ushtarake të pajisjeve të kontrolluara nga Lista e Përbashkët Ushtarake e Bashkimit Evropian

### **ML22 "Teknologjitë" si më poshtë:**

- a. "Teknologjia" e ndryshme nga ato të specifikuar në ML22.b., "të kërkuara" për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e artikujve të përcaktuara në Listën e Përbashkët Ushtarake.
- b. "Teknologjitë" e mëposhtme:
  1. "Teknologjia" "e nevojshme" për hartimin, lidhjet e komponentëve, dhe përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e instalimeve të plota të prodhimit për artikujt e përcaktuar në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-, edhe nëse komponentët e instalimeve të tilla të prodhimit nuk janë të specifikuar.
  2. "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillimin" dhe "prodhimin" e armëve të vogla edhe nëse përdoret për të prodhuar riprodhime të armëve antike të vogla.
  3. "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e agjentëve toksikologjikë, pajisje të lidhura me to ose përbërës të kontrolluar nga ML7.a deri në ML7.f.
  4. "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" "biopolimereve" ose kulturave të qelizave specifike të kontrolluara nga ML7.h.
  5. "Teknologjia" "e kërkuar" ekskluzivisht për inkuorporimin e "biokatalizatorëve" të specifikuar në ML7.h.1, në substancat mbartëse ushtarake ose materialet ushtarake.

*Shënim 1: "Teknologjia" që kërkohet për "zhvillimin" dhe "prodhimin" ose "përdorimin" e artikujve të kontrolluara në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së mbetet nën kontroll edhe në rastet kur përdoret në ndonjë artikull që nuk është specifikuar në listën në fjalë.*

*Shënim 2: ML22 nuk zbatohet për:*

- a. "teknologjinë" që është minimumi i nevojshëm për instalimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e artikujve që nuk janë të kontrolluar ose të cilët janë të autorizuar për eksport;
- b. "teknologjinë" që është "në zotërim publik", "kërkim themelor shkencor" ose informacioni minimal i nevojshëm për aplikimet për patenta;
- c. "teknologjinë" për induksionin magnetik për shtytjen e vazhdueshme të pajisjeve transportuese civile.

### **PËRKUFIZIMET E TERMAVE TË PËRDORURA NË KËTË LISTË**

Në vijim paraqiten përkufizimet e termave të përdorura në këtë listë, në rend alfabetik.

*Shënim 1: Përkufizimet zbatohen për të gjithë listën. Referencat shërbejnë vetëm për qëllime këshillimi dhe nuk ndikojnë në zbatimin universal të termave të përcaktuara në të gjithë listën.*

*Shënim 2: Fjalët dhe termat e përfshira në këtë listë përkufizimesh marrin kuptimin e përkufizuar vetëm atëherë kur janë të vendosura në "thonjëza dyshe". Në të gjitha rastet e tjera, fjalët dhe termat marrin kuptimin e pranuar gjerësisht (sipas fjalorëve).*

ML8 "Aditivë"

Substancat e përdorura në krijimin lëndëve plasëse për të përmirësuar karakteristikat e tyre.

ML7 "Agjentë për kontrollin e trazirave"

Substancat të cilat, në kushte të pritshme të përdorimit për qëllime të kontrollit të trazirave, shkaktojnë shpejt të njerëzit irritim ose efekte fizike që i bëjnë ata të paaftë, efekte të cilat zhduken brenda një kohe të shkurtër pas përfundimit të ekspozimit (një nënndarje e "agjentëve për kontrollin e trazirave" janë gazet lotsjellës).

ML11 "Sisteme të automatizuara të komandimit dhe kontrollit"

Pajisjet elektronike përmes së cilave hyjnë, përpunohen dhe transmetohen informacione thelbësore për funksionimin efektiv të grupit, për formimin e përgjithshëm, për formimin taktik, për njësinë, transportin, nën njësinë ose sistemet e armëve në dispozicion. Kjo arrihet përmes përdorimit të kompjuterit dhe pajisjeve të tjera të specializuara, të projektuara për të mbështetur funksionet e komandimit dhe kontrollit të organizatave ushtarake. Funksionet kryesore të një sistemi të automatizuar komandimi dhe kontrolli janë: mbledhja, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave në mënyrë të automatizuar dhe efikase; zbulimi i situatës dhe rrethanave që ndikojnë në përgatitjen dhe kryerjen e operacioneve luftarake; llogaritjet operationale dhe taktike për shpërndarjen e burimeve ndërmjet grupeve luftarake ose elementet e rendit operativ ose orarin e luftimeve, në përputhje me misionin apo fazën e operacionit; përgatitjen e të dhënave për vlerësimin e situatës dhe marrjen e vendimeve në çdo moment gjatë operacionit apo luftimeve; simulimi kompjuterik i operacioneve.

ML10 "Avion pa ekuipazh" ("UAV")

Çdo "avion" i aftë për të fluturuar dhe për të ruajtur fluturimin dhe navigacionin e kontrolluar në fluturim pa praninë e njeriut në bord.

ML7, 22 "Biokatalizatorë"

Enzima për reaksione kimike dhe biokimike të posaçme ose përbërje të tjera biologjike, të cilat lidhen, ose përshpejtojnë degradimin e agjentëve të luftës kimike.

*Shënim teknik*

Termi "enzima" nënkupton "biokatalizatorët" për reaksione kimike dhe biokimike të posaçme.

ML7,22 "Biopolimere"

Makromolekulat biologjike si më poshtë:

a. Enzimët për reaksione të caktuara kimike ose biokimike;

b. Antitruapat monoklonalë, poliklonalë ose anti-idiotipikë;

c. Receptorët e projektuar ose të përpunuar posaçërisht;

Shënim teknik

1. "Antitruapa anti-idiotipikë" janë antitruapat që lidhen me pozicionet e lidhura antigjene specifike të antitrupeve të tjerë

2 "Antitruapa monoklonalë" janë proteina të cilat lidhen në një vend antigjen dhe janë prodhuar nga një klon i vetëm qelizash;

3 "Antitruapa poliklonalë" janë një përzierje proteinash të cilat lidhen me një antigjen specifik dhe janë prodhuar nga më shumë se një klon qelizash

4. "Receptorë" janë strukturat biologjike makromolekulare të afta për të lidhur ligande, lidhja e të cilave ndikon në funksionet fiziologjike.

ML15 "Llamba intensifikuese të imazhit të gjeneratës së parë"

Llamba të fokusuara elektrostatische që përdorin fibra optike hyrëse dhe dalëse ose anoda me faqe xhami, fotokatoda multi-alkale (S-20 ose S-25), por jo anoda mikrokanale amplifikuese.

ML10 "Avionë civilë"

"Avionët" e përfshirë në listën e botuar të certifikimit të aftësisë për të fluturuar nga autoritetet civile, të cilët fluturojnë në rrugët tregtare të brendshme apo ndërkombëtare dhe janë të destinuara për përdorim të ligjshëm civil, privat apo të biznesit.

ML8, 18 "Lëndë plasëse"

Substancat e ngurta, të lëngëta dhe të gazta ose përzierjet e substancave të cilat të cilat kërkohet që të shpërthejnë, në zbatimin e tyre si parësore, shtytëse ose ngarkesë kryesore në mbushjet e raketave, shkatërrimin e tyre, dhe zbatime të tjera.

ML7 "Vektorë të shprehjes"

Transportuesit (p.sh. plazmidet ose viruset) e përdorur për të futur materialin gjenetik në qelizat pritëse.

ML4, 8 "Materiale energjetike"

Substancat ose përzierjet që reagojnë kimikisht për të lëshuar energjinë që kërkohet për përdorimin e tyre të synuar. "Lëndët plasëse", "artikujt piroteknikë" dhe "mbushjet shtytëse" janë nënkategori të materialeve energjetike.

ML19 "Të kualifikuar për përdorim në hapësirë"

Produktet janë të projektuar, prodhuar dhe testuar për të përmbushur kërkesat e veçanta elektrike, mekanike apo mjedisore për përdorim në nisjen dhe dislokimin e satelitëve apo të sistemeve të avionëve të lartësisë së lartë që operojnë në lartësi 100 km ose më shumë.

ML17 "Qelizë karburanti"

Pajisja elektrokimike e cila, duke përdorur lëndë djegëse nga një burim i jashtëm, konverton drejtpërdrejtë energjinë kimike në energji elektrike DC.

ML5, 19 "Laser"

Seti i komponentëve që prodhojnë njëkohësisht dritë në hapësirë dhe në kohë dhe që përforcohet nga emetimi i stimuluar i rrezatimit.

ML17 "Reaktor bërthamor"

Përfshin artikujt brenda ose të bashkëngjitura në pjesët e reaktorit, pajisjet që kontrollojnë nivelin e fuqisë në bërthamë, si dhe përbërësit që normalisht përmbajnë ose vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë ose kontrollojnë ftohësin parësor të bërthamës së reaktorit.

ML4, 8 "Piroteknike"

Përzierjet e lëndëve djegëse të ngurta ose të lëngëta dhe oksiduesit të cilët, kur ndizen, i nënshtrohen një reaksion kimik energjetik në një normë të kontrolluar për të prodhuar vonesa kohore specifike, ose sasi nxehtësie, tymi, dritë të dukshme ose rrezatimi me rreze infra të kuqe. Piroforidet janë një nënndarje e artikujve piroteknikë, të cilët nuk përmbajnë oksidues, por ndizen në mënyrë spontane pas kontaktit me ajrin.

ML8 "Mbushje shtytëse"

Substanca ose përzierje që reagojnë kimikisht për të prodhuar volume të mëdha të gazesh të nxehta, në masa të kontrolluara, për të kryer punë mekanike.

ML22 "E nevojshme"

Aplikuar në "teknologji", i referohet vetëm asaj pjese të "teknologjisë" që është veçanërisht përgjegjëse për arritjen ose tejkalimin e niveleve të kontrolluara të performancës, karakteristikave ose funksioneve. "Teknologjia" e nevojshme mund të ndahet nga produkte të ndryshme.

ML8 "Prekursorët"

Kimikate të veçanta të përdorura në prodhimin e lëndëve plasëse.

ML7 "Përshtatur për përdorim në luftë"

Çdo modifikim ose përzgjedhje (si alternimi i pastërtisë, kohës së staxhionimit, virulencës, karakteristikave të shpërndarjes, ose rezistencës ndaj rrezatimit ultravjollcë) e projektuar për rritje të efektivitetit në shkaktimin e viktimave në njerëz dhe kafshë, në shkatërrimin e pajisjeve ose në dëmtimin e të mbjellave ose të mjedisit.

ML21, 22 "Prodhim"

Nënkupton të gjitha fazat e prodhimit si: projektimin e produktit, prodhimin, integrimin, analizën, inspektimin, testimin dhe kontrollin e cilësisë.

ML21 dhe ML22 "Zhvillimi"

Lidhet me të gjitha fazat përpara prodhimit në seri, si: projektimi, kërkimi mbi projektimin, analiza e projektimit, konceptet e projektimit, mbledhja dhe testimi i prototipave, skemat e prodhimit pilot, të dhënat e projektimit, procesi i transformimit të prototipit në produkt, konfigurimi i projektimit, integrimi i projektimit, planifikimi.

## ML17 "Robot"

Një mekanizëm manipulimi, i cili mund të veprojë në një rrugë të vazhdueshme ose pike pas pike, mund të përdorë sensorë dhe ka të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- a. Është shumëfunksional;
- b. Është i aftë për të pozicionuar ose orientuar materiale, pjesë, mjete ose pajisje të veçanta përmes lëvizjeve të ndryshueshme në një hapësirë tredimensionale;
- c. përfshin tre ose më shumë pajisje shërbimi të mbyllura ose të hapura të cilët mund të përfshijnë motorët;
- d. Ka "Mund të programohet nga përdoruesi" me mjetet e metodave të mësimi dhe rikthimit ose përmes mjeteve të një kompjuteri elektronik i cili mund të jetë një kontrollues logjik i programueshëm, pa ndërhyrje mekanike.

*Shënim:* Përkufizimi i mësipërm nuk përfshin pajisjet e mëposhtme;

1. Mekanizmat e manipulimit të cilët mund të kontrollohen vetëm manualisht ose në mënyrë teleoperatore;
2. Mekanizmat e manipulimit të sekuencave fikse, të cilët janë pajisje lëvizëse të automatizuara që operojnë sipas lëvizjeve të programuara mekanike fikse. Programi kufizohet mekanikisht nga ndalesa të fiksuara si p.sh. kapëset, ose pajisjet e kompjuterizuara. Sekuenca e lëvizjeve dhe përcaktimi i rrugëve dhe këndeve nuk mund të ndryshohen nga mjete mekanike, elektronike ose elektrike;
3. Mekanizmat e manipulimit të sekuencave të ndryshueshme të kontrolluara mekanikisht, të cilat janë pajisje lëvizëse të automatizuara që operojnë sipas lëvizjeve të programuara mekanike fikse. Programi kufizohet mekanikisht nga ndalesa të fiksuara por të rregullueshme, të tilla si kapëset ose pajisjet kompjuterike. Sekuenca e lëvizjeve dhe përcaktimi i drejtimit dhe këndeve janë të ndryshueshme brenda modelit fikse të programit. Ndryshimet ose modifikimet e modelit të programit (p.sh. ndryshimet e kapëseve ose ndërrimet e pajisjeve kompjuterike) në një ose më shumë akse të lëvizjes kryhen vetëm nëpërmjet veprimeve mekanike;
4. Mekanizmat e manipulimit të sekuencave të ndryshueshme jo ndihmës kontrolluese, që veprojnë në bazë të lëvizjeve fikse të programuara mekanikisht. Programi është i ndryshueshëm por sekuenca ndjek vetëm sinjalin binar nga pajisjet mekanike fikse elektrike binare ose ndalesa të ndryshueshme;
5. Vinçat e përcaktuar si sisteme manipuluese të koordinatave karteziene të prodhuara si pjesë integrale e një rreshtimi vertikal të depozitave të ruajtjes dhe të projektuar për të pasur akses në përmbajtjen e këtyre depozitave për t'i ruajtur apo për t'i korrigjuar.

## ML21 "Softuer"

Një përmbledhje e një ose disa "programeve" ose "mikroprogrameve" të fiksuara në çfarëdo medie shprehjeje.

## ML 20 "Superpërrjellës"

I referohet materialeve (p.sh. metaleve, aliazheve ose përzierjeve) të cilat mund të humbasin të gjithë rezistencën elektrike (p.sh. ata që mund të arrijnë një përcjellshmëri elektrike të pafundme dhe të mbajnë sasi shumë të mëdha rryme elektrike pa nxehtë Xhaul).

*"Temperatura kritike" (1 3 6) (ndonjëherë e quajtur edhe temperaturë kalimtare) e një materiali superpërcjellës është temperatura në të cilën materiali e humbet rezistencën e tij ndaj rrymës së drejtpërdrejtë.*

#### *Shënim teknik*

Gjendja "superpërcjellëse" e një materiali karakterizohet individualisht nga një "temperaturë kritike", një fushë magnetike kritike, e cila është një funksion i temperaturës; ose dendësi rryme kritike, e cila është një funksion i fushës magnetike dhe temperaturës.

#### ML11 "Anijet kozmike"

Satelitët dhe sondat hapësinore aktive dhe pasive.

#### ML22 "Teknologji"

Informacion specifik i nevojshëm për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e një produkti të veçantë. Informacioni merr formën e të dhënave teknike ose të asistencës teknike.

#### *Shënime teknike*

1. "Të dhënat teknike" mund të marrin formën e planeve, diagrameve, projekteve, modeleve, formulave, tabelave, skicimeve inxhinierike dhe specifikimeve, manualeve ose udhëzimeve të shkruara ose të regjistruara në mjete të tjera të komunikimit ose pajisje si disk, shirit ose memorieve lexuese.

2. "Asistenca teknike" mund të marrë formën e udhëzimeve, aftësive, trajnimeve, njohurive të punës dhe shërbimeve të konsulencës. "Asistenca teknike" mund të përfshijë transferimin e "të dhënave teknike".

#### ML22 "Kërkim shkencor bazë"

Studimet eksperimentale dhe teorike të ndërmarra kryesisht për të fituar njohuri të reja rreth parimeve themelore, fenomeneve ose fakteve të vërejtura, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me një qëllim ose objektiv të caktuar praktik.

#### ML22 "Në zotërim publik"

Nënkupton "teknologjitë" apo "programet kompjuterike" që janë në dispozicion për përdorim publik pa kufizime në shpërndarjen e tyre të mëtejshme.

*Shënim:* Kufizimet e të drejtës së autorit nuk e përjashtojnë "teknologjinë" ose "softuerët" nga të qenit "në zotërim publik."

#### ML21, 22 "Përdorim"

Përdorimi, instalimi (përfshirë edhe instalimin në vend), mirëmbajtja (kontrolli), riparimi, kolaudimi dhe rinovimi.

#### ML13 "Materialet fibroze ose prej filamenti"

Përfshijnë:

a. Filamente të vazhdueshme;

- b. Fije të ndërthurura të vazhdueshme;
- c. Shiritat, pëlhurat, kordonët, mbulesa;
- d. Fibrat e prera, fibrat e kapura, mbulojat me fibra koherente;
- e. Fije monokristaline ose polikristaline të çdo gjatësie
- f. Tul poliamide aromatike.

ML10 "Mjetet e transportit më të lehta se ajri"

Balonat dhe avionët që përdorin ajër të nxehtë ose gaz më të lehtë se ajri të si heliumi apo hidrogjeni.

ML17 "Elementet fundore"

Mbërthyeset, njësitë aktive të përpunimit mekanik dhe çdo përpunim tjetër mekanik i bashkëngjitur me pjesën bazë në fund të një krahu manipulues "robot".

*Shënim teknik*

"Njësitë aktive të përpunimit mekanik" janë pajisje për rritje të fuqisë, përpunimit të energjisë ose ndjeshmërisë ndaj një pjese pune.

ML8, ML10 dhe ML14 "Avionë"

Mjete fluturuese me krahë të fiksuar, të kthyeshëm, rrotullues (helikopter) dhe me rotor ose krahë që mund të anohen."

## **SHTOJCA II**

### **LISTA E PRODUKTEVE MBROJTJES**

*Shënim 1: Termat "në thonjëza" janë përkufizime. Referojuni seksionit "Përkufizime të termave të përdorura në këtë listë që gjendet bashkëngjitur.*

*Shënim 2: Përbërjet kimike janë paraqitur sipas emrit dhe Numrit CAS. Lista zbatohet për përbërjet kimike të të njëjtës formulë strukturore (ku përfshihen hidratet) pavarësisht nga emri ose numri CAS. Numrat CAS tregohen për të ndihmuar në identifikimin e një përbërje apo përzierje të caktuar kimike, pavarësisht nga nomenklatura. Numrat CAS nuk mund të përdoren si identifikuesit e vetëm sepse disa forma të përbërjeve kimike të listuara kanë numra të ndryshëm CAS dhe përzierjet që përmbajnë një nga përbërjet kimike të listuara mund të kenë po ashtu numra të ndryshëm CAS.*

**ML1 armët pa vjaska me kalibër më të vogël se 20 mm, armët e tjera dhe armët automatike të kalibrit 12,7 mm ose më pak (kalibër 0,50 inç) dhe aksesorët dhe përbërësit e projektuar posaçërisht për to, si më poshtë:**

- a. Pushkët, karabinat, revolverët, pistoletat, pistoletat automatike dhe automatikët:

Shënim: ML1.a. nuk përfshin:

*a. Mushqetat, pushkët dhe karabinat e prodhuara përpara vitit 1938;*

*b. Riprodhimet e mushqetave, pushkëve dhe karabinave dhe ato origjinale të prodhuara përpara vitit 1890;*

*c. Revolverët, pistoletat dhe automatikët e prodhuar përpara vitit 1890 dhe riprodhimet e tyre;*

b. Armët pa vjaska, si më poshtë:

1. Armët pa vjaska të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak

2. Armët e tjera pa vjaska si më poshtë:

a. Plotësisht automatike;

b. Gjysmë-automatike ose me mekanizëm pompimi;

c. Armët që përdorin municion pa gëzhojë;

d. Silenciatorët, pjesët e veçanta që montohen në armë, karikatorët, shënjestrat dhe zhurmëmbytësit për armët e parashikuara në ML1.a, ML1.b ose ML1.c.

*Shënim 1: ML1 nuk zbatohet për armët pa vjaska që përdoren qëllime gjuetie ose sportive. Këto armë nuk duhet të jenë të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe nuk duhet të jetë automatike.*

*Shënim 2: ML1 nuk zbatohet për armët e zjarrit të projektuara për qitje me municion manovre dhe që nuk mund të përdorin asnjë nga municionet e specifikuar në ML3.*

*Shënim 3: ML1 nuk zbatohet për armët e zjarrit që përdorin municion në këllëf municion me ndezje anësore dhe që nuk janë plotësisht automatike.*

*Shënim 4: ML1 nuk zbatohet për armët me shënjestër optike pa përpunim elektronik të imazhit, me zmadhim deri katër herë ose më pak, nëse ato nuk janë projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak.*

**ML2 armët pa vjaska me kalibër 20 mm e lart, armë të tjera ose armatim me kalibër më të madh se 12,7 mm (kalibër 0,50 inç), predhat e aksesorët më poshtë, si dhe komponentët e projektuara posaçërisht për to:**

a. Armët, obuzat, topat, armët anti-tanke, lëshuesit e predhave, flakë hedhësit ushtarakë, pushkët, armët pa mekanizëm zbrapsjeje, armët pa vjaska dhe pajisjet e reduktimit të flakës në tytën e armëve përkatëse;

*Shënim 1: ML2.a. përfshin injektorët, pajisjet matëse, depozitat ruajtëse dhe përbërës dhe pajisje të tjera për përdorim me ngarkesa me shtytje të lëngët për ndonjë nga pajisjet e kontrolluara nga ML2.a.*

*Shënim 2: ML2.a. nuk zbatohet për armët si më poshtë:*

*a. Mushqetat, pushkët dhe karabinat e prodhuara përpara vitit 1938;*

*b. Riprodhimet e mushqetave, pushkëve dhe karabinave ato origjinale, të prodhuara përpara vitit 1890.*

*c. Armët, obusët, topat dhe mortajat e prodhuara përpara vitit 1890.*

c. Nuk përfshijnë armët e përcaktuara në listën e përbashkët ushtarake, përveçse nëse ato janë të padëmshme dhe në funksion të tyre.

**ML11 Pajisjet elektronike, "anijet kozmike" dhe komponentët e tyre që nuk janë përmendur në asnjë mënyrë në listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian, si më poshtë vijon:**

a. Pajisjet elektronike të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe komponentët e projektuar për to;

*Shënim: ML11.a. përfshin:*

a. Pajisjet kundërvepruese dhe pajisjet elektronike kundër -kundërvepruese (p.sh pajisjet e projektuara për të lëshuar sinjale të huaja ose të gabuara në radar ose në pajisjet e lidhjes me radio ose që të pengojnë marrjen, punën ose efektivitetin e pajisjeve marrëse të kundërshtarit), ku përfshihen dhe pajisjet e tyre kundër-kundërvepruese

b. Llambat e frekuencave të shpejta;

c. Sistemet elektronike ose pajisjet e projektuara dhe për zbulim dhe monitorim të spektrit elektromagnetik për zbulimin ushtarak ose për qëllime sigurie ose për kundërveprimin dhe mbikëqyrjen e tyre;

d. Kundërveprimet nën ujë, ku përfshihen zhurmimi dhe prishja e sinjalit akustik, pajisjet e projektuara për të lëshuar sinjale të huaja ose të gabuara në pajisjen marrëse të hidrolokatorit;

e. Pajisjet e përpunimit të të dhënave të sigurisë, pajisjet e të dhënave të sigurisë dhe të transmetimit dhe sinjalizimit që përdorin proceset e kodimit;

f. Pajisjet identifikuese, të autenticitetit, shkarkuese dhe menaxhuese, prodhuese dhe shpërndarëse;

g. Pajisjet udhëzuese dhe orientuese;

h. Pajisjet e transmetimit të radio-komunikimeve dixhitale;

i. Demulatorët dixhitalë të projektuar posaçërisht për zbulimin e sinjaleve.

j. "Sistemet e automatizuara të komandimit dhe kontrollit."

VINI RE: Për "softuerët" lidhur me radiot e përcaktuara nga "softueri"(SDR), shihni ML21.

b. Pajisjet bllokuese të sistemeve satelitore të navigimit dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

**ML12 Sistemet e armëve me energji të lartë kinetike dhe pajisjet e projektuara posaçërisht për to, si më poshtë:**

- a. Sistemet e armëve me energji të lartë kinetike të projektuara posaçërisht për të shkatërruar objektivin ose për të anuluar shkatërrimin e tij;
- b. Pajisjet e projektuara posaçërisht për testim dhe vlerësim dhe modelet e testimit, përfshirë instrumentet diagnostifikuese dhe objektivat, për testim dinamik të raketave dhe sistemeve me energji kinetike.

*VINI RE: Për sistemet e armëve që përdorin municion nën-kalibër ose që përdorin barute kimike me municionet për këto armë, shih ML1 deri në MLA.*

#### ML12 (vazhdim)

*Shënim 1: ML12 përfshin sistemet e armëve me energji kinetike në vijim:*

- a. Sisteme shtytëse lëshuese që mund t'i japin shpejtësi masave më të mëdha se 0.1 g në shpejtësi më të mëdha se 1.6 km/s, si në modelin e qitjes një nga një dhe në atë të qitjes me shpejtësi;
- b. Sistemet që sigurojnë energji kryesore, mbrojtje elektrike, ruajtje të energjisë, menaxhim termik, manovrim të karburantit; dhe ndërfaqet elektrike midis burimit të energjisë, armës dhe funksioneve të tjera elektrike që ndikojnë;
- c. Sistemet për përcaktimin e pozicionit dhe ndjekjen e objektivit, për kontrollin e zjarrit dhe për vlerësimin e dëmit;
- d. Sistemet e kërkimit të objektivit, sistemet orientuese ose shmangëse të shtyrjes (shpejtësia laterale) për raketat.

*Shënim 2: ML12 zbatohet për sistemet e armëve që përdorin si forcë shtytëse një nga metodat e mëposhtme:*

- a. Elektromagnetike;
- b. Elektrotermale;
- c. Plazma;
- d. Gaz i lehtë; ose
- e. Kimike (kur përdoret në kombinim me ndonjë nga elementët e mësipërm).

#### **ML13 Pajisjet e blinduara ose mbrojtëse, strukturat dhe përbërësit si më poshtë:**

- a. Pllakat e blinduara si më poshtë:
  1. Të prodhuara në përputhje me standardet ushtarake; ose
  2. Të përshtatshme për përdorim ushtarak;

*VINI RE: Pllakat mbrojtëse të destinuara për anti-plumbat shih ML13.d.2.*

- b. Konstruksionet e materialeve metalike ose jo metalike ose kombinimet e tyre të projektuara për të siguruar mbrojtje balistike për sistemet ushtarake dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

c. Helmetat e prodhuara në përputhje me standardet ose specifikimeve ushtarake, ose sipas standardeve kombëtare të krahasueshme, dhe komponentët e posaçëm të tyre, (p.sh., kasketat, jelekët për zbutjen e goditjes;

d. Jelekët antiplumb, veshjet mbrojtëse dhe komponentët e tyre, si më poshtë:

1. Jelekët antiplumb, veshjet mbrojtëse dhe pajisjet e projektuara për to, të prodhuara në përputhje me standardet ushtarake ose ekuivalentet e tyre;

*Shënim: Për qëllimet e ML13.d.1, standardet ose specifikimet ushtarake përfshijnë të paktën specifikimet për mbrojtjen nga copëzat e mbeturinave.*

2. Pllakat e forta të jelekëve mbrojtës që ofrojnë mbrojtje balistike të barabartë ose më të madhe se niveli III (NIJ 0101.06, korrik 2008) ose ekuivalentet kombëtare.

*Shënim 1: ML13.b. përfshin materialet e projektuara posaçërisht për të siguruar mbrojtje nga armët e shpërthimit reaktiv ose për ndërtimin e strehimeve ushtarake.*

*Shënim 2: ML13.c nuk zbatohet për helmetat konvencionale prej çeliku, as ato të modifikuara ose të projektuara për tu pranuar, as ato të pajisura me pjesë shtesë;*

*Shënim 3: ML13.c. dhe d. nuk zbatohet për helmetat, jelekët antiplumb ose veshjet mbrojtëse të përdorura për mbrojtjen personale të përdoruesit.*

*Shënim 4: Helmetat e vetme të projektuara posaçërisht për personelin e çmontimit të bombave që përcaktohen me hollësi tek ML13, janë ato të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak*

*VINI RE 1: Shih gjithashtu IA005 në listën e mallrave me përdorim të dyfishtë.*

*VINI RE 2: Për "materialet fibroze ose prej filamenti" të përdorura për prodhimin e jelekëve antiplumb dhe helmetave, shih IC010 në listën e mallrave me përdorim të dyfishtë të BE-së.*

**ML14 Pajisjet e specializuara për stërvitje ushtarake ose për simulim të skenarëve ushtarakë, simulatorët e projektuar posaçërisht për stërvitje në përdorimin e ndonjë arme zjarri ose arme të përcaktuar në ML1 ose ML2, dhe komponentët e pajisjet e projektuara posaçërisht për to.**

*Shënim teknik*

*Termi "pajisje të specializuara për stërvitje ushtarake" përfshin llojet e simulatorëve të sulmit, simulatorëve operacionalë të fluturimit, simulatorët e radarëve të objektivave, gjeneratorët e gjetjes së objekteve, pajisjet e stërvitjes me top, simulatorët e stërvitjes për luftën kundër nëndetëseve, simulatorët e fluturimit (ku përfshihen dhe centrifugat për njerëzit për stërvitjen e pilotëve dhe astronautëve), pajisjet e stërvitjes për radarët, simulatorët e fluturimit me instrumente, simulatorët e orientimit, simulatorët e lëshimit të raketave, pajisjet e gjetjes së objektivit, avionëve pa personel, simulatorët e armatimit, simulatorët e "avionëve" pa ekuipazh, njësitë e stërvitjes së lëvizshme dhe pajisjet për operacionet tokësore.*

*Shënim 1: ML14 përfshin sistemet për gjenerimin e imazhit dhe ambienteve ndërvepruese për simulatorët, kur janë të projektuara ose të modifikuara për përdorim ushtarak.*

*Shënim 2: ML14 nuk zbatohet për pajisjet e projektuara posaçërisht për stërvitje dhe përdorimin e armëve të gjetisë ose armëve sportive.*

**ML15 Pajisjet e imazhit ose të kundërveprimit dhe komponentët dhe aksesorët e tyre në vijim, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak:**



- a. Regjistruarit dhe pajisjet e përpunimit të imazhit;
- b. Kamerat, pajisjet fotografuese dhe të përpunimit të filmit;
- c. Pajisjet intensifikuese (përforcuese) të imazhit;
- d. Pajisjet me rreze infra të kuqe ose pajisjet termike të imazhit;
- e. Pajisjet për fotografimin e sensorëve të radarëve
- f. Pajisjet e kundërveprimit ose të kundër-kundërveprimit për pajisjet e specifikuar në ML15.a deri në ML15.e.

*Shënim: ML15.f. f. përfshin pajisjet e projektuara për të reduktuar veprimin ose efektivitetin e sistemeve ushtarake të imazhit ose për të minimizuar këto efekte reduktuese.*

*Shënim 1: Në ML15, termi "komponentë të projektuar posaçërisht" përfshin, komponentët e mëposhtëm kur janë të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak:*

- a. Llambat e konvertimit të imazhit infra të kuq;
- b. Kinoscope/llambat e intensifikimit të imazhit (përveç atyre të gjeneratës së parë);
- c. Pllakat me mikrokanale;
- d. Llambat e kamerave televizive me nivel të ulët ndriçimi
- e. Shigjetat detektuese (ku përfshihen ndërlidhja elektronike ose sistemet lexuese);
- f. Llambat piroelektrike të kamerave televizive;
- g. Sistemet e ftohjes për sistemet e imazhit;
- h. Diafragmat me mbyllje elektrike të tipit fotokromik ose të tipit elektro-optik që kanë një shpejtësi të diafragmës më të vogël se 100 μs, përveçse në rastet të cilat janë pjesë bazë e një aparati fotografik për shpejtësi të larta;
- i. Inverterat e imazhit me fibër optike;
- j. Fotokatodat e përbëra gjysmëpërcjellëse.

*Shënim 2: ML15 nuk zbatohet për "llambat intensifikuese {përforcuese} të gjeneratës së parë" ose pajisjet e projektuara posaçërisht për t'u bashkuar në llambat intensifikuese {përforcuese} të gjeneratës së parë".*

*VINI RE: Për klasifikimin e shënjestrave të armëve që përfshijnë "llamba intensifikuese të gjeneratës së parë", shih ML1, ML2 dhe ML5.a.*

*VINI RE: Shih gjithashtu 6A002.a.2. dhe 6A002.b. në listën e mallrave me përdorim të dyfishtë.*

**ML16 Produktet e farkëtuara, të derdhura dhe produkte të tjera të papërfunduara, të projektuara posaçërisht për artikujt e specifikuar në ML1 deri në ML4, ML6, ML9, ML10, ML12 ose ML19.**

*Shënim: ML16. zbatohet për produktet e papërfunduara, kur ato janë të identifikueshme nga përbërja e materialit, gjeometria ose funksioni.*

**ML17 Pajisje, materiale dhe dokumentacione të ndryshme, dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to:**

a. Të gjitha pajisjet për zhytje si më poshtë:

1. Aparatet me qarkullim të mbyllur ose gjysmë të mbyllur (rifrymëmarrje) të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak (p.sh. të projektuara posaçërisht për të qenë jo magnetik);
2. Përbërësit e projektuar posaçërisht për të kthyer aparatit e qarkullimit të hapur për përdorim ushtarak;
3. Artikujt personalë të zhytjes dhe aparati për notim nën ujë, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak.

b. Pajisjet e ndërimit të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

c. Montimet, veshjet dhe trajtimet për fshehje gjurmësh, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

d. Pajisjet xheniere fushore të projektuara për përdorim në zonën e luftimit;

e. "Robotët", kontrolluesit e "robotëve" dhe "ndikuesit fundorë", që kanë ndonjë nga karakteristikat që vijojnë:

1. Janë projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak;
2. Mjetet e inkorporuar të mbrojtjes së linjave hidraulike ndaj shpimit nga fragmentet balistike (p.sh. inkorporojnë linja vetizoluese) dhe janë projektuar për të përdorur lëngje hidraulike në pikë ndezje më të lartë se 839 K (566 °C); ose
3. Janë projektuar posaçërisht ose kategorizohen për të vepruar në një mjedis me rrymë elektromagnetike;

*Shënim teknik*

*Pulset elektromagnetike nuk i referohen efektit të ndërsjellë të shkaktuar në mënyrë të paqëllimshme nga rrezatimi elektromagnetik nga pajisjet në afërsi (p.sh., makineritë dhe pajisjet elektronike) ose për shkak të rrufeve*

f. Bibliotekat (bazat e të dhënave me parametra teknike) të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak me pajisjet e kontrolluara nga Lista e Përbashkët Ushtarake e BE-së;

g. Pajisjet e gjenerimit të energjisë bërthamore ose pajisjet shtytëse, ku përfshihen "reaktorët bërthamorë", komponentët e tyre të projektuara për përdorim ushtarak;

h. Pajisjet dhe materialet, e veshura ose të përpunuara për maskim të gjurmës, të projektuara për përdorim ushtarak, përveç atyre të kontrolluara në vend tjetër në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së;

i. Simulatorët e projektuar veçanërisht për reaktorët bërthamorë ushtarakë;

j. Ofiçinat e lëvizshme të riparimit të projektuara ose modifikuara për riparimin e mjeteve ushtarake;

k. Gjeneratorët për në terren, të ndërtuar ose modifikuar për përdorim ushtarak;

l. Kontejnerët e projektuar ose modifikuar për përdorim ushtarak;

m. Tragetet, përveç atyre të specifikuara në pika të tjera në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së, urat dhe mjetet lundruese të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

n. Modelet e testit të projektuara posaçërisht për "zhvillimin" e artikujve të përcaktuar në ML4, ML6, ML9 ose ML10.

o. Pajisjet e mbrojtjes laser (p.sh. mbrojtje e sensorit dhe e syrit) të prodhuara posaçërisht për përdorim ushtarak.

ML17 (vazhdim)

p. "Qelizat e karburantit" përveç atyre të specifikuara diku tjetër në Listën Ushtarake, të projektuara ose modifikuara për përdorim ushtarak.

*Shënime teknike*

1. Për qëllimin e ML17, termi "bibliotekë" ((bazë të dhënash – me parametra teknike) do të thotë mënyrat e grumbullimit të informacionit teknik me natyrë ushtarake, referencë për të cilën mund të rrisë performancën e sistemeve ose pajisjeve ushtarake.

2. Për qëllimin e ML17, "modifikim" do të thotë çdo ndryshim strukturor, elektrik, mekanik, që i jep një artikulli jo ushtarak mundësinë ekuivalente me një artikull që është projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak.

**ML18 Pajisjet për prodhimin e produkteve të përmendura në Listën e Përbashkët Ushtarake, si më poshtë:**

a. Produktet e projektuara ose të modifikuara posaçërisht për "prodhimin" e produkteve të renditura në Listën e Përbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian, dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

b. Pajisjet e testimit mjedisor dhe pajisjet e tyre, të projektuara posaçërisht për to, për certifikim, për klasifikimin ose testimin e produkteve të kontrolluara nga Lista e Përbashkët Ushtarake e BE-së.

*Shënim teknik*

*Për qëllimet e ML18, termi "prodhim" përfshin projektimin, ekzaminimin, prodhimin, testimin dhe kontrollin.*

*Shënim: ML18.a dhe ML18.b përfshijnë pajisjet e mëposhtme:*

*a. Pajisjet për nitrim të vazhdueshëm;*

*b. Aparatet e testimit centrifugal ose pajisjet që kanë karakteristikat e mëposhtme:*

*1. Vihen në punë nga një motor ose motorë me fuqi më të madhe se 298 kw (400 kuaj fuqi);*

*2. Kanë kapacitet për të mbajtur ngarkesa prej 113 kg ose më shumë; ose*

3. Kanë kapacitet për të ushtruar përsheptim centrifugal prej 8 g ose më shumë në një ngarkesë 91 kg ose më të madhe;

c. Presat dehidratuese;

d. Nxjerrësit e vidave të projektuar ose të modifikuar për nxjerrjen e eksplozivëve ushtarakë;

e. Makineritë prerëse për lëndët shtytëse të dala;

f. Mbështetëset (mbajtëset) me diametër 1,85 m ose më tepër dhe me kapacitet më të madh se 277 kg;

g. Përzierësit e vazhdueshëm për lëndët shtytëse të ngurta (përzierësit e barutit);

h. Mullinjtë e energjisë fluide për grirje ose copëtim të përbërësve të eksplozivëve ushtarakë;

i. Pajisjet për arritjen e madhësisë së grimcës dhe të formës sferike të pluhurit të metalit të paraqitur në listën ML8.c.8;

j. Konvertuesit me konveksion të rrymës për shndërrimin e materialeve të listuara në ML8.c.3

**ML19 Sistemet e armëve me energji të drejtuara (DEW), pajisjet e lidhura ose pajisjet e kundërmasave dhe modelet e testimit, si dhe përbërësit e projektuar posaçërisht për to, si më poshtë:**

a. Sistemet "Laser" të projektuar posaçërisht për shkatërrim ose për anulim të misionit të objektivit;

b. Sistemet me rryma grimcash të afta për shkatërrim ose për anulim të misionit të objektivit;

c. Sistemet me radiofrekuencë të lartë (RF), të cilat janë në gjendje të shkatërrojë ose të anulojnë detyrën e synuar;

d. Pajisjet e projektuar posaçërisht për zbulimin dhe identifikimin sistemeve të përcaktuara në ML19.a deri në ML19.c ose për mbrojtjen ndaj tyre;

ML19 (vazhdim)

e. Modelet e testit fizik për sistemet, pajisjet dhe komponentët e përcaktuar në ML19.

f. Sistemet "laser" të projektuar posaçërisht për të shkaktuar humbje të përhershme të shikimit, nëse sytë nuk janë të mbrojtura, p.sh për syrin e lirë, ose për syrin me pajisje korigjuese;

*Shënim 1: Sistemet e armëve me energji të drejtuar (pajisjet DEW) të përcaktuara në ML19 përfshijnë sistemet aftësia e të cilave rrjedh nga zbatimi i kontrolluar i:*

a. "Laserëve" me fuqi të mjaftueshme për të shkaktuar shkatërrim të ngjashëm me atë të municionit tradicional;

b. Përsheptuesve të grimcave që projektojnë një tufë të ngarkuar ose neutrale me fuqi shkatërruese;

c. Radiotransmetuesve me frekuencë me pulsime të larta dhe me fuqi mesatare të lartë që prodhojnë fusha të tilla të forta që nxjerrin jashtë funksionit qarqet elektronike të një objekti të largët.

*Shënim 2: ML19 përfshin si më poshtë vijon, kur janë projektuar posaçërisht për sistemet e armëve me energji të drejtuar (sistemet DEW);*

- a. Pajisjet për gjenerimin e energjisë kryesore, ruajtjen e energjisë, kyçjen-shkyçjen, kushtëzimin e fuqisë ose manovrimin e karburantit;
- b. Sistemet për kapjen ose ndjekjen e objektivit
- c. Sistemet e vlerësimit të dëmtimit të objektivit, shkatërrimit ose braktisjes së misionit;
- d. Pajisjet e manovrimit të tufave të rrezes së përhapjes ose shënimit të një pike;
- e. Pajisjet me lëvizje të shpejtë të tufës së rrezeve për veprimet e shpejta e të shumëfishta me objektivin;
- f. Optika përshtatëse dhe bashkuesit e fazave;
- g. Injektorët e rrymave për tufat e joneve negative të hidrogjenit;
- h. Komponentët e përsheptuar "të kualifikuar për përdorim në hapësirë";
- i. Pajisjet për grumbullimin e rrezeve negative të jonit;
- j. Pajisjet për kontrollin dhe devijimin e tufave të joneve me energji të lartë;
- k. Mbrojtëset "e kualifikuara hapësinore" për neutralizimin e rrymave të izotopeve negative të hidrogjenit.

**ML20 Pajisjet kriogjenike dhe "superpërcjellëse" siç tregohet në vijim përbërësit dhe aksesorët e projektuar posaçërisht për to:**

- a. Pajisjet e projektuara ose të konfiguruar për t'u instaluar në një mjet për forcat tokësore, forcat detare, forcat ajrore, ose zbatimet hapësinore, të afta të punojnë ndërsa janë në lëvizje dhe të prodhojnë ose të ruajnë temperatura nën 103 K (-170 °C);

*Shënim: ML20.a përfshin sistemet e lëvizshme që inkorporojnë ose përdorin aksesorë ose përbërësit e prodhuar nga materiale jo metalike ose jo elektrike, si plastika ose materialet epokside të pasuruara.*

- b. Pajisjet elektrike "superpërcjellëse" (makineritë rrotulluese dhe transformatorët) e projektuar ose të konfiguruar posaçërisht për t'u instaluar në një mjet për forcat detare, tokësore, forcat ajrore ose zbatimet hapësinore, të afta për të punuar ndërsa janë në lëvizje.

*Shënim: ML20.b nuk zbatohet për gjeneratorët hibridë homopolar me rrymë të vazhduar që kanë armatura me një pol të vetëm metali dhe rrotullohen në një fushë magnetike të prodhuara nga bobina superpërcjellëse, por me kusht që këto pështjellime të jenë i vetmi komponent superpërcjellës në gjenerator.*

**ML21 "Softuerët", si më poshtë:**

- a. "Softuerët" e projektuar ose të modifikuar për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e pajisjeve ose materialeve të specifikuar në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së;

- b. "Softuerët" e posaçëm, përveç atyre të përcaktuara në ML21.a., si më poshtë:

1. "Softuerët" e projektuar posaçërisht për modelimin, simulimin ose vlerësimin e sistemeve të armëve ushtarake;

2. "Softuerët" e projektuar posaçërisht për modelimin ose simulimin e skenarëve dhe operacioneve ushtarake;
  3. "Softuerët" për përcaktimin e efekteve të luftës konvencionale, bërthamore, kimike ose biologjike.
  4. "Softuerët" e projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak i dizajnuar për komandimin, komunikimin, kontrollin dhe shërbimet e inteligjencës (C3I) aplikimeve; ose komandimin, komunikimin, kontrollimin, llogaritjen dhe shërbimet e inteligjencës (C4I);
- c. "Softuerët" që nuk janë specifikuar në ML21.a. ose b., të projektuar ose modifikuar për t'u mundësuar pajisjeve që nuk kontrollohen nga Lista e Përbashkët Ushtarake që të kryejnë funksionet ushtarake të pajisjeve të kontrolluara nga Lista e Përbashkët Ushtarake e Bashkimit Evropian

## **ML22 "Teknologjia" si më poshtë:**

- a. "Teknologjia" e ndryshme nga ato të specifikuar në ML22.b., "të kërkuara" për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e artikujve të përcaktuara në Listën e Përbashkët Ushtarake.
- b. "Teknologjitë" e mëposhtme:
  1. "Teknologjia" "e nevojshme" për hartimin, lidhjet e komponentëve, dhe përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e instalimeve të plota të prodhimit për artikujt e përcaktuar në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-, edhe nëse komponentët e instalimeve të tilla të prodhimit nuk janë të specifikuar.
  2. "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillimin" dhe "prodhimin" e armëve të vogla edhe nëse përdoret për të prodhuar rirprodhime të armëve antike të vogla.
  3. "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e agjentëve toksikologjikë, pajisje të lidhura me to ose përbërës të kontrolluar nga ML7.a deri në ML7.f.
  4. "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e "biopolimereve" ose kulturave të qelizave specifike të kontrolluara nga ML7.h.
  5. "Teknologjia" "e kërkuar" ekskluzivisht për inkorporimin e "biokatalizatorëve" të kontrolluar nga ML7.h.1, në substancat mbartëse ushtarake ose materialet ushtarake.

*Shënim 1: "Teknologjia" që kërkohet për "zhvillimin" dhe "prodhimin" ose "përdorimin" e artikujve të specifikuar në Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së mbetet nën kontroll edhe në rastet kur përdoret në ndonjë artikull që nuk është specifikuar në këtë listë.*

*Shënim 2: ML22 nuk zbatohet për:*

- a. "Teknologjinë" që është minimumi i nevojshëm për instalimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e artikujve që nuk janë të kontrolluar ose të cilët janë të autorizuar për eksport;
- b. "Teknologjinë" që është "në zotërim publik", "kërkim themelor shkencor" ose informacioni minimal i nevojshëm për aplikimet për patenta;
- c. "Teknologjinë" për induksionin magnetik për shtytjen e vazhdueshme të pajisjeve transportuese civile.

## **PËRKUFIZIMET E TERMAVE TË PËRDORURA NË KËTË LISTË**

Në vijim paraqiten përkufizimet e termave të përdorura në këtë listë, në rend alfabetik.

*Shënim 1: Përkufizimet zbatohen për të gjithë listën. Referencat shërbejnë vetëm për qëllime këshillimi dhe nuk ndikojnë në zbatimin universal të termave të përcaktuara në të gjithë listën.*

*Shënim 2: Fjalët dhe termat e përfshira në këtë listë përkufizimesh marrin kuptimin e përkufizuar vetëm atëherë kur janë të vendosura në "thonjëza dyshe". Në të gjitha rastet e tjera, fjalët dhe termat marrin kuptimin e pranuar gjerësisht (sipas fjalorëve).*

#### **ML8 "Aditivë"**

Substancat e përdorura në krijimin e lëndëve plasëse për të përmirësuar karakteristikat e tyre.

#### **ML7 " Agjentë për kontrollin e trazirave"**

Substancat të cilat, në kushte të pritshme të përdorimit për qëllime të kontrollit të trazirave, shkaktojnë shpejt të njerëzit irritim ose efekte fizike që i bëjnë ata të paaftë, efekte të cilat zhduken brenda një kohe të shkurtër pas përfundimit të ekspozimit (një nënndarje e "agjentëve për kontrollin e trazirave" janë gazet lotsjellës).

#### **ML11 "Sisteme të automatizuara të komandimit dhe kontrollit"**

Pajisjet elektronike përmes së cilave hyjnë, përpunohen dhe transmetohen informacione thelbësore për funksionimin efektiv të grupit, për formimin e përgjithshëm, për formimin taktik, për njësinë, transportin, nën njësinë ose sistemet e armëve në dispozicion. Kjo arrihet përmes përdorimit të kompjuterit dhe pajisjeve të tjera të specializuara, të projektuara për të mbështetur funksionet e komandimit dhe kontrollit të organizatave ushtarake. Funksionet kryesore të një sistemi të automatizuar komandimi dhe kontrolli janë: mbledhja, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave në mënyrë të automatizuar dhe efikase; zbulimi i situatës dhe rrethanave që ndikojnë në përgatitjen dhe kryerjen e operacioneve luftarake; llogaritjet operacionale dhe taktike për shpërndarjen e burimeve ndërmjet grupeve luftarake ose elementet e rendit operativ ose orarin e luftimeve, në përputhje me misionin apo fazën e operacionit; përgatitjen e të dhënave për vlerësimin e situatës dhe marrjen e vendimeve në çdo moment gjatë operacionit apo luftimeve; simulimi kompjuterik i operacioneve.

#### **ML10 "Avion pa ekuipazh" ("UAV")**

Çdo "avion" i aftë të fluturuar dhe për të ruajtur kontrollin dhe navigacionin në fluturim, pa praninë e njeriut bord.

#### **ML7, 22 "Biokatalizatorë"**

Enzima për reaksione kimike dhe biokimike të posaçme ose përbërje të tjera biologjike, të cilat lidhen, ose përshpejtojnë degradimin e agjentëve të luftës kimike.

#### *Shënim teknik*

Termi "enzima" nënkupton "biokatalizatorët" për reaksione kimike dhe biokimike të posaçme apo reaksioneve biokimike.

#### **ML7,22 "Biopolimere"**

Makromolekulat biologjike si më poshtë:

- a. Enzimata për reaksione të caktuara kimike ose biokimike;
- b. Antitruapat monoklonalë, poliklonalë ose anti-idiotipikë;

c. Receptorët e projektuar ose të përpunuar posaçërisht;

Shënim teknik

1. "Antitropa anti-idiotipikë" janë antitrupat që lidhen me pozicionet e lidhura antigjene specifike të antitrupave të tjerë

2 "Antitropa monoklonalë" janë proteina të cilat lidhen në një vend antigjen dhe janë prodhuar nga një klon i vetëm qelizash;

3 "Antitropa poliklonalë" janë një përzierje proteinash të cilat lidhen me një antigjen specifik dhe janë prodhuar nga më shumë se një klon qelizash

4. "Receptorë" janë strukturat biologjike makromolekulare të afta për të lidhur ligande, lidhja e të cilave ndikon në funksionet fiziologjike.

#### **ML15 " Llama intensifikuese të imazhit të gjeneratës së parë"**

Llama të fokusuara elektrostatische që përdorin fibra optike hyrëse dhe dalje ose anoda me faqe xhami, fotokatoda multi-alkale (S-20 ose S-25), por jo anoda mikrokanale amplifikuese.

#### **ML10 "Avionë civil"**

"Avionët", e përfshirë në listën e botuar të certifikimit të aftësisë për të fluturuar nga autoritetet civile, të cilët fluturojnë në rrugët tregtare të brendshme apo ndërkombëtare dhe janë të destinuara për përdorim të ligjshëm civil, privat apo të biznesit.

#### **ML8, 18 "Lëndë plasëse"**

Substancat e ngurta, të lëngëta dhe të gazta ose përzierjet e substancave të cilat të cilat kërkohet që të shpërthejnë, në zbatimin e tyre si parësore, shtytëse ose ngarkesë kryesore në mbushjet e raketave, shkatërrimin e tyre, dhe zbatime të tjera.

#### **ML7 "Vektorë të shprehjes"**

Transportuesit (p.sh., plazmidet ose viruset) e përdorur për të futur materialin gjenetik në qelizat pritëse.

#### **ML4, 8 "Materiale energjetike"**

Substancat ose përzierjet që reagojnë kimikisht për të lëshuar energjinë që kërkohet për përdorimin e tyre të synuar. "Lëndët plasëse", "artikujt piroteknikë" dhe "mbushjet shtytëse" janë nënkategori të materialeve energjetike.

#### **ML19 "Të kualifikuar për përdorim në hapësirë"**

Produktet janë të projektuar, prodhuar dhe testuar për të përmbushur kërkesat e veçanta elektrike, mekanike apo mjedisore për përdorim në nisjen dhe dislokimin e satelitëve apo të sistemeve të avionëve të lartësisë së lartë që operojnë në lartësi 100 km ose më shumë.

#### **ML17 "Qelizë karburanti"**

Pajisja elektrokimike e cila, duke përdorur lëndë djegëse nga një burim i jashtëm, konverton drejtpërdrejt energjinë kimike në energji elektrike DC.



#### ML5, 19 "**Laser**"

Seti i komponentëve që prodhojnë njëkohësisht dritë në hapësirë dhe në kohë dhe që përforcohet nga emetimi i stimuluar i rrezatimit.

#### ML17 "**Reaktor bërthamor**"

Përfshin artikujt brenda ose të bashkëngjitura në pjesët e reaktorit, pajisjet që kontrollojnë nivelin e fuqisë në bërthamë, si dhe përbërësit që normalisht përmbajnë ose vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë ose kontrollojnë ftohësin parësor të bërthamës së reaktorit.

#### ML4, 8 "**Piroteknike**"

Përzierjet e lëndëve djegëse të ngurta ose të lëngëta dhe oksiduesit të cilët, kur ndizen, i nënshtrohen një reaksion kimik energjetik në një normë të kontrolluar për të prodhuar vonesa kohore specifike, ose sasi nxehtësie, tymi, dritë të dukshme ose rrezatimi me rreze infra të kuqe. Piroforidet janë një nën-ndarje e artikujve piroteknikë, të cilët nuk përmbajnë oksidues, por ndizen në mënyrë spontane pas kontaktit me ajrin.

#### ML8 "**Mbushje shtytëse**"

Substanca ose përzierje që reagojnë kimikisht për të prodhuar volume të mëdha të gazesh të nxehta, në masa të kontrolluara, për të kryer punë mekanike.

#### ML22 "**E nevojshme**"

Aplikuar në "teknologji", i referohet vetëm asaj pjese të "teknologjisë" që është veçanërisht përgjegjëse për arritjen ose tejkalimin e niveleve të kontrolluara të performancës, karakteristikave ose funksioneve. "Teknologjia" e nevojshme mund të ndahet nga produkte të ndryshme.

#### ML8 "**Prekursorët**"

Kimikate të veçanta të përdorura në prodhimin e lëndëve plasëse.

#### ML7 "**Përshtatur për përdorim në luftë**"

Çdo modifikim ose përzgjedhje (si alternimi i pastërtisë, kohës së staxhionimit, virulencës, karakteristikave të shpërndarjes, ose rezistencës ndaj rrezatimit ultravjollcë) e projektuar për rritje të efektivitetit në shkaktimin e viktimave në njerëz dhe kafshë, në shkatërrimin e pajisjeve ose në dëmtimin e të mbjellave ose të mjedisit

#### ML18, 21, 22 "**Prodhim**"

Nënkupton të gjitha fazat e prodhimit, si: projektimin e produktit, prodhimin, integrimin, analizën, inspektimin, testimin dhe kontrollin e cilësisë.

#### ML21, 22 "**Zhvillimi**"

Lidhet me të gjitha fazat përpara prodhimit në seri, si: projektimi, kërkimi mbi projektimin, analiza e projektimit, konceptet e projektimit, mbledhja dhe testimi i prototipave, skemat e prodhimit pilot, të dhënat e projektimit, procesi i transformimit të prototipit në produkt, konfigurimi i projektimit, integrimi i projektimit, planifikimi.

#### ML17 "**Robot**"

Një mekanizëm manipulimi, i cili mund të veprojë në një rrugë të vazhdueshme ose pike pas pike, mund të përdorë sensorë dhe ka të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

a. Është shumëfunksional;

b. Është i aftë për të pozicionuar ose orientuar materiale, pjesë, mjete ose pajisje të veçanta përmes lëvizjeve të ndryshueshme në një hapësirë tredimensionale;

c. Përfshin tre ose më shumë pajisje shërbimi të mbyllura ose të hapura, të cilat mund të përfshijnë motorët;

d. "Mund të programohet nga përdoruesi" përmes metodave të mësimit dhe rikthimit ose përmes mjeteve të një kompjuteri elektronik i cili mund të jetë një kontrollues logjik i programueshëm, pra, pa ndërhyrje mekanike.

*Shënim:* Përkufizimi i mësipërm nuk përfshin pajisjet e mëposhtme;

1. Mekanizmat e manipulimit të cilët mund të kontrollohen vetëm manualisht ose në mënyrë teleoperatore;

2. Mekanizmat e manipulimit të sekuencave fikse, të cilët janë pajisje lëvizëse të automatizuara që operojnë sipas lëvizjeve të programuara mekanike fikse. Programi kufizohet mekanikisht nga ndalesa të fiksuara si p.sh. kapëset, ose pajisjet e kompjuterizuara. Sekuenca e lëvizjeve dhe përcaktimi i rrugëve dhe këndeve nuk mund të ndryshohen nga mjete mekanike, elektronike ose elektrike;

3. Mekanizmat e manipulimit të sekuencave të ndryshueshme të kontrolluara mekanikisht, të cilat janë pajisje lëvizëse të automatizuara që operojnë sipas lëvizjeve të programuara mekanike fikse. Programi kufizohet mekanikisht nga ndalesa të fiksuara por të rregullueshme, të tilla si kapëset ose pajisjet kompjuterike. Sekuenca e lëvizjeve dhe përcaktimi i drejtimit dhe këndeve janë të ndryshueshme brenda modelit fikse të programit. Ndryshimet ose modifikimet e modelit të programit (p.sh. ndryshimet e kapëseve ose ndërrimet e pajisjeve kompjuterike) në një ose më shumë akse të lëvizjes kryhen vetëm nëpërmjet veprimeve mekanike;

4. Mekanizmat e manipulimit të sekuencave të ndryshueshme jo ndihmës kontrolluese, që veprojnë në bazë të lëvizjeve fikse të programuara mekanikisht. Programi është i ndryshueshëm por sekuenca ndjek vetëm sinjalin binar nga pajisjet mekanike fikse elektrike binare ose ndalesa të ndryshueshme;

5. Vinçat e përcaktuar si sisteme manipuluese të koordinatave karteziiane të prodhuara si pjesë integrale e një rreshtimi vertikal të depozitave të ruajtjes dhe të projektuar për të pasur akses në përmbajtjen e këtyre depozitave për t'i ruajtur apo për t'i korrigjuar.

#### **ML21 "Softuer"**

Një përmbledhje e një ose disa "programeve" ose "mikroprogrameve" të fiksuara në çfarëdo medie shprehjeje.

#### **ML 20 "Superpërrjellës"**

I referohet materialeve (p.sh. metaleve, aliazheve ose përzierjeve) të cilat mund të humbasin të gjithë rezistencën elektrike (p.sh. ata që mund të arrijnë një përcjellshmëri elektrike të pafundme dhe të mbajnë sasi shumë të mëdha rryme elektrike pa nxehtë Xhaul).

*"Temperatura kritike" (1 3 6) (ndonjëherë e quajtur edhe temperaturë kalimtare) e një materiali superpërrjellës është temperatura në të cilën materiali e humbet rezistencën e tij ndaj rrymës së drejtpërdrejtë.*

### *Shënim teknik*

Gjendja "superpërcjellëse" e një materiali karakterizohet individualisht nga një "temperaturë kritike", një fushë magnetike kritike, e cila është një funksion i temperaturës; ose dendësi rryme kritike, e cila është një funksion i fushës magnetike dhe temperaturës.

### **ML22 "Teknologji"**

Informacion specifik i nevojshëm për "zhvillimin", "prodhimin" ose "përdorimin" e një produkti të veçantë. Informacioni merr formën e të dhënave teknike ose të asistencës teknike.

### *Shënime teknike*

1. "Të dhënat teknike" mund të marrin formën e planeve, diagrameve, projekteve, modeleve, formulave, tabelave, skicimeve inxhinierike dhe specifikimeve, manualeve ose udhëzimeve të shkruara ose të regjistruara në mjete të tjera të komunikimit ose pajisje si disk, shirit ose memorieve lexuese.

2. "Asistenca teknike" mund të marrë formën e udhëzimeve, aftësive, trajnimeve, njohurive të punës dhe shërbimeve të konsulencës. "Asistenca teknike" mund të përfshijë transferimin e "të dhënave teknike".

### **ML22 "Kërkim shkencor bazë"**

Studimet eksperimentale dhe teorike që janë përdorur në përgjithësi për fitimin e njohurive të reja të parimeve themelore të fenomeneve apo faktet e vërejtura, të cilat nuk janë drejtuar direkt drejt një qëllim të caktuar apo aplikim praktik.

### **ML22 "Në zotërim publik"**

Nënkupton "teknologjitë" apo "programet kompjuterike" që janë në dispozicion për përdorim publik pa kufizime në shpërndarjen e tyre të mëtejshme.

*Shënim:* Kufizimet e të drejtës së autorit nuk e përjashtojnë "teknologjinë" ose "softuerët" nga të qenit "në zotërim publik."

### **ML21, 22 "Përdorim"**

Përdorimi, instalimi (përfshirë edhe instalimin në vend), mirëmbajtja (kontrolli), riparimi, kolaudimi dhe ripërpunimi.

### **ML13 "Materialet fibroze ose prej filamenti"**

Përfshijnë:

- a. Monofilamentet e vazhdueshme;
- b. Fije të ndërthurura të vazhdueshme;
- c. Shiritat, pëlhurat, kordonët, mbulesat;
- d. Fibrat e prera, fibrat e kapura, mbulesat me fibra koherente;
- e. Fijet monokristaline ose polikristaline të çdo gjatësie

f. Tul poliamide aromatike.

#### ML10 "Mjetet e transportit më të lehta se ajri"

Balonat dhe avionët që përdorin ajër të nxehtë ose gaz më të lehtë se ajri të si heliumi apo hidrogjeni.

#### ML17 "Ndikuesit fundorë"

Mbërthyeset, njësitë aktive të përpunimit mekanik dhe çdo përpunim tjetër mekanik i bashkëngjitur me pjesën bazë në fund të një krahu manipulues "robot".

#### Shënim teknik

"Njësitë aktive të përpunimit mekanik" janë pajisje për rritje të fuqisë, përpunimit të energjisë ose ndjeshmërisë ndaj një pjese pune.

#### ML8, ML10 dhe ML14 "Avionë"

Mjete fluturuese me krahë të fiksuar, të kthyeshëm, rrotullues (helikopter) dhe me rotor ose krahë që mund të anohen."

### ANEKSI III.

#### LISTË E MJETEVE LUFTARAKE JO USHTARAKE

KODI	EMËRTIMI
<b>2904</b>	<b>Sulfo- Nitro ose hidrokarbure të nitruara, pavarësisht nëse janë apo jo të halogjenizuara:</b>
ex. 2904 20 001	- derivatet që përmbajnë vetëm grupe nitro ose nitrike:
	- - dinitrobenzen
	- - di- dhe trinitrotoluen
<b>2920</b>	<b>Esteret e acideve të tjera organike e jometalike (duke përjashtuar esteret e halogjen hidrogjenit) dhe kripërat e tyre; derivatet e tyre të halogjenizuara, sulfuruara apo të nitruara:</b>
2920 90	- tjetër:
ex. 2920 90 85	- - tjetër:
	- - - nitroglicerinë
	- - - pentaeritritoltetranitrat (pentrit)
	- - - estere të tjera të acidit nitrik
	- - - estere të acideve të tjera
<b>3601 00 00</b>	<b>Barut:</b>
<b>3602 00 00</b>	<b>Lëndë plasëse e gatshme, përveç barutit:</b>
<b>3603 00</b>	<b>Fitilat me ndezje të ngadaltë; fitilat detonues; kapsulat plasëse ose shpërthyes; ndezësit; detonatorët elektrikë</b>
3603 00 10	Fitilat me ndezje të ngadaltë, fitilat detonues
3603 00 90	- tjetër
<b>3604</b>	<b>Fishekzjarrët, raketat sinjalizuese, raketat kundër breshrit, raketat sinjalizuese për mjegullën dhe artikujt e tjerë piroteknikë</b>
ex. 3604 10 002	- fishekzjarrë

3604 90 00	- tjetër
<b>9302 00 00</b>	<b>Revolverët dhe pistoletat, përveç atyre të specifikuara në 9303 deri në 9304</b>
<b>9303</b>	<b>Armë zjarri të tjera dhe pajisje të ngjashme të cilat funksionojnë me djegie të lëndëve shpërthyes (për shembull, çiftet dhe armët e gjahut me tyta të pavjaskuara dhe të vjaskuara për gjueti, sport ose qitje, armët e zjarrit që mbushen nga tyta, pistoletat sinjalizuese, pistoletat për vrasjen e kafshëve, gjuajtësit e konopëve të anijeve)</b>
9303 10 00	- armë zjarri me mbushje nga tyta
9303 20	- çifte të tjera për sport, gjah ose qitje, me të paktën një tytë të pavjaskuar, duke përfshirë edhe kombinime të çiftes me armë me tytë të vjaskuar
9303 20 10	- - pushkë me një tytë të pavjaskuar
9303 20 95	- - tjetër
9303 30 00	- pushkë të tjera për gjah, sport ose qitje
9303 90 00	- tjetër
<b>ex. 9304 00 003</b>	<b>Armë të tjera (p.sh., armët dhe pistoletat me sustë, me ajër ose me gaz dhe shkopinjtë), përveç atyre të specifikuara në 9307</b>
<b>9305</b>	<b>Pjesë dhe aksesore për artikujt e specifikuara në 9301 deri në 9304:</b>
ex. 9305 10 004	-: për revolverët dhe pistoletat
9305 20 00	- për çiftet dhe armët me vjaska të specifikuara në kodin 9303
	- tjetër:
9305 99 00	- - tjetër
<b>9306</b>	<b>Bomba, granata, silurë, mina, raketa dhe municione të ngjashme për luftë, si dhe pjesët e tyre; plumba (fishekë) dhe municione e predha të tjera, si dhe pjesët e tyre, duke përfshirë edhe plumbat (fishekët) me mbushje dhe ato manovër:</b>
	<b>- plumba (fishekë) për pushkët dhe pjesët e tyre: fishekët për pushkët me ajër</b>
9306 21 00	- - plumba (fishekë)
9306 29 00	- - tjetër
9306 30	- municione të tjera dhe pjesët e tyre
9306 30 10	- - për revolverët dhe pistoletat e specifikuara në kodin 9302 dhe për armët gjysmë-automatike të specifikuara në kodin 9301
	- - tjetër:
ex. 9306 30 90 5	- - - tjetër

<sup>1</sup> Për substancën "nitrobenzene", nuk nevojitet licencë.

<sup>2</sup> Për artikujt piroteknikë të kategorisë I, II., III., P1 dhe T1, sipas ligjit "Për lëndët plasëse" ("Fletorja Zyrtare" nr.: 178/04, 109/07, 67/08 dhe 144/10), nuk nevojitet licencë.

<sup>3</sup> Objekt i kontrollit sipas kësaj shtojce janë vetëm shkopinjtë (shkopinjtë e gomës).

<sup>4</sup> Objekt i kontrollit sipas kësaj shtojce janë pjesët dhe pajisjet për revolverët apo pistoletat për qëllime ushtarake

<sup>5</sup> Kontrollit sipas kësaj shtojce nuk i nënshtrohen fishekët për veglat e perçinimit ose vegla të ngjashme, ose për pistoletat me ajër për vrasjen e kafshëve dhe për pjesët e tyre.

